

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI

VENDIM

Nr. 81, datë 29.04.2026

PËR

LICENCIMIN E BANKËS “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA., PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË AGJENTIT NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “SIGAL LIFE INSURANCE GROUP” SH.A., DHE SHOQËRISË SË SIGURIMIT “ALBSIG JETË” SH.A., DHE MIRATIMIN AGJENTËVE NË SIGURIME, NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË BANKËS “INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA” SHA.,

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe të rregullores nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Licencimin e bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a. për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jetës, në emër e për llogari të shoqërive të sigurimit “Sigal Life Insurance Group” sh.a. dhe “Albsig Jetë” sh.a.
2. Miratimin e znj. Ariana Vreto, znj. Ersilida Koçi, znj. Martine Lleshi, znj. Migena Abdyli, znj. Sabina Skuka, znj. Athina Shyti, znj. Aurora Petushi, znj. Esi Kapaj, znj. Vojsava Bakiasi, znj. Servi Kiku, znj. Xhevrije Hoxha për ushtrimin e veprimtarisë së agjentit në sigurime, në klasat e jetës, në emër dhe për llogari bankës “Intesa Sanpaolo Bank Albania” sh.a.
3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI